

Ekskluzive | I drejtoi armën policit gjatë ndjekjes në Pejë, arrestohet 19-vjeçari



Sinjali.com

18 Korrik 2026 10:40



Një ndjekje dramatike në rrugët e Pejës ka përfunduar me arrestimin e një 19-vjeçari, i cili dyshohet se i drejtoi armën një zyrtari policor teksa tentonte t'i ikte Policisë, raporton Sinjali.

Sinjali mëson ekskluzivisht se i dyshuari është **Argjend Afrim Osdautaj** rreth 19-vjeçar.

Sipas burimeve të **Sinjalit**, gjithçka nisi pas një njoftimi të një qytetari se një veturë Mercedes A-Class, me ngjyrë të zezë, po kryente manovra të rrezikshme në trafik.

Një patrullë policore u vu në ndjekje të automjetit, ndërsa në zonën e fidanishteve, pranë rrugës "Tifozët Kuq e Zi", i dyshuari braktisi veturën dhe tentoi të largohej në këmbë, duke mbajtur një çantë krahu.

Sipas Policisë, në momentin kur zyrtarët iu afruan për ta arrestuar, 19-vjeçari nxori një pistoletë dhe e drejtoi në drejtim të një polici, duke rrezikuar seriozisht jetën e tij.

Policët arritën ta neutralizonin dhe t'ia merrnin armën, ndërsa gjatë arrestimit një zyrtar policor pësoi lëndime të lehta (gërvishtje) në tricepsin e dorës së majtë.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitë hetimore, krimteknika e stacionit policor dhe hetuesit rajonalë, të cilët kanë kryer ekzaminimin dhe kanë sekuestruar provat materiale.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit, ndaj **Argjend Afrim Osdautajt** është iniciuar hetim për veprat penale "Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm" dhe "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve".

Pas intervistimit, Prokurori ka caktuar ndaj tij masën e ndalimit policor prej 48 orësh, ndërsa hetimet për rastin janë në vazhdim.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera